

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Problemet funksionale

Legjislacioni suedez ofron kujdes shëndetësor dhe ndihmë për ata që vuajnë nga probleme funksionale. Individët zakonisht mund të rikthehen në shëndet të plotë pas një sëmundje ose plagosje por një problem funksional zakonisht ndikon mbi një individ për gjithë jetën. Kufizimet funksionale ndodhin kur mjedisi lokal nuk është adoptuar për një individ me probleme funksionale.

Pajisja dhe rehabilitimi

Shërbimi i pajisjes dhe rehabilitimit për fëmijët, të rinjtë dhe të rritur në Bashkinë e Rrethit Kronoberg ju ofron personave me probleme funksionale mjete të cilat lehtësojnë jetën e tyre të përditshme.

Qendra e përkthyesve ofron shërbime përkthimi për individë të cilët janë shurdh, shurdh-memec dhe të cilët kanë probleme serioze me dëgjimin. Ju keni të drejtën e një përkthyesi në të gjitha situatat ku duhet të kuptoni dhe të kuptoheni nga të tjerët. Shërbimi i përkthyesve është falas dhe mund të organizohet nëpërmjet Qendrës së Përkthyesve të Bashkisë së Rrethit.

Telefononi 112 për raste urgjente kur kërkohet një përkthyer për shembull në raste urgjencash. Më shumë informacion mund të gjeni në faqen: www.ltkronoberg.se/tolkcentralen.

Këshillimi për shëndetin nëpërmjet tekst-telefonit ofrohet për ata të cilët kanë probleme me dëgjimin, janë shurdh ose vuajnë nga probleme me të folurin. SOS Alarm e ofron këtë shërbim dhe numri i tyre i telefonit është: 020 33 00 00.

Teletal (telezëri) është një shërbim telefonik ndihme për ata që vuajnë nga probleme me të folurin, kanë probleme me zërin ose kanë vështirësi me gjuhën. Ju mund të zgjidhni shërbimin “Teletal” kur telefoni centralin e bashkisë së rrethit. Më shumë informacion mund të merrni në faqen: www.teletal.se

Mjetet dhe pajisjet ndihmëse

Hjälpmedelscentralen ofron mjete dhe pajisje ndihmëse për fëmijët dhe adoleshentët deri në moshën 18 vjeçare. Hjälpmedelscentralen ju ofron të rriturve karroca elektrike, pajisje dalluese dhe komunikuese, mjete ndihmëse për trajtimin dhe trajnimin si dhe zgjedhje të avancuara për t’u ulur. Të gjitha pajisje dhe mjetet e tjera ofron nga autoritete bashkiake. Më shumë informacion mund të merrni në faqen: www.hjalpmedel.kronoberg.se

Shoqatat e pacientëve dhe invalidëve

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Faqja e Bashkisë së Rrethit përfshin një listë të shoqatave të ndryshme të Shëndetit dhe Përkujdesjes. Kërkoni "organizata për pacientë dhe invalidë" (Suedisht - Sök på Patient- och handikapporganisationer). Ju mund të mësoni më shumë rreth shoqatave në të gjitha bibliotekat dhe qendrat e informimit.

Växjö: 0470 58 70 70, 58 76 42,

Ljungby: 0732 58 54 30.

Informacioni në dispozicion

Bashkia e Rrethit Kronoberg ofron informacion të përshtatshëm përfshi informacionin e incizuar, të thjeshtë për t'u kuptuar, filma me gjuhë me shenja dhe disa informacione të cilat janë përkthyer në gjuhë të tjera.

Mësoni më shumë duke lexuar faqen tonë: www.ltkronoberg.se